

# RELACION TEKNIK

OBJEKTI :

*“ PERMISIMI I INFRASTRUKTURES VENDORE DHE*

*RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN*

*PRANE PALLATIT TE KULTURES ”*

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

### 1. - TË PËRGJITHSHME

- 1.1 - Hyrje
- 1.2 - Pozicioni i objektit
- 1.3 - Gjëndja Ekzistuese
- 1.4 - Studimi Topografik
- 1.5 - Studimi Gjeologjik
- 1.6 - Studimi Hidrologjik

### 2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- 2.1 - Projekti i Rruges
- 2.2 - Sinjalistika Rrugore
- 2.3 - Konkluzione



## 1.- TË PËRGJITHSHME

### 1.1 - HYRJE

#### Pozicioni gjeografik :

Peshkopia eshte kryeqendra e Bashkise Diber dhe shtrihet ne zonen verilindore te Shqiperise me nje lartesi 670 m nga niveli i detit dhe cila kufizohet ne lindje me Maqedonine ne veri me Kukesit ne jug me Buqizes e ne perendim me Burrelin , dhe ne distance rrugore nga Tirana eshte rreth 185 km. Eshte zone kryesisht malore dhe e gjelbert, me klime mesdhetare, me vere te ngrohte dhe dimet te ftohte, por per shkak te pozicionit te saj ne afersi te maleve, dimri zgjat rreth 5 - 6 muaj.

#### Horografia e Qytetit :



Planifikimi urban :

Struktura urbane e Peshkopise eshte e krahasueshme me modelin e nje qyteti kompakt. Jashte qendres se qytetit ka disa lagje si psh Dobrove, Kallavere dhe Kamen. Jashte qytetit ndodhen disa fshatra qe jane nen "influencen" e Peshkopise. Qendra e qytetit eshte e pozicionuar ne te majte dhe ne te djathte te aksit rrugor ndermjet pallatit te vjeter te kultures, ndertese e cila do te perdoret ne te ardhmen si godina e re e bashkise, dhe pallatit te sportit. Shumica e godinave te rendesishme dhe funksioneve bashkiake jane te ndertuara pergjate rruges kryesore, sic jane psh, zyrat e bashkise, pallati i ri dhe i vjeter i kultures, godina e telekomit, ish-hotel turizmi, shkolla e mesme e pergjithshme e qytetit dhe nje sere zyrash me funksion gjysem publik. Ne krye dhe ne fund te rruges kryesore jane vendosur funksione te rendesishme: ne anen perendimore eshte spitali dhe ne anen lindore eshte zona historike e quajtur "teqe" ku ndodhet edhe muzeu i qytetit. Qyteti ekzistues eshte i ndare ne dy pjese nga nje zone e gjere e gjelberuar ("lugina" e perroit). Pjesa me e madhe e qytetit shtrihet ne anen perendimore kurse zona me e madhe e banuar jashte qytetit eshte Dobrova, e cila shtrihet ne anen lindore. Zona e ndertuar ne menyren me te jashteligjshme eshte zona ndermjet qendres se qytetit dhe llixhave, zone e cila perben anen verilindore te qytetit. Kjo pjese e qytetit nuk eshte pjese e zones se percaktuar nga vija e verdhe. Ne perendim te qendres se qytetit, ndodhet zona qe me pare funksiononte si zone industriale per te gjitha llojet e ndermarrjeve, por qe aktualisht eshte lene jashte funksionit per shkak te kushteve ekonomike. Kjo zone ka potencial per t'u rinovuar dhe rehabilituar. Lagja Kamen ndodhet ne anen veriore te qendres se qytetit ku rreth 5000 banore jetojne nen kushtet minimale. Kjo zone ka cilesi te dobet. Nje nga problemet e ardhshme me te cilat do te perballtet qyteti, eshte presioni qe do te ushtrohet nga trafiku dhe transporti. Aktualisht i tere trafiku kalon neper qendren e qytetit. Meqenese shume qytetare i kane shtepite e tyre ne qender te qytetit, patjeter duhet menduar seriozisht per gjetjen e rrugeve alternative per trafikun jashte qendres se qytetit dhe ne te njejten kohe pa krijuar probleme per zhvillimin normal te aktivitetit te njesive qe ndodhen a ty. Eshte plotesisht e mundur qe trafiku te rritet shume shpejt brenda pak vitesh si rezultat i zhvillimit te pritshem ekonomik. Sidoqofte, qyteti nuk ka potencial per zmadhim apo zgjerim ne te ardhmen. Zonat ku aktualisht eshte ndertuar, perfshire edhe a to zona ku eshte ndertuar pa leje, duhet te futen brenda vijes se verdhe. Kjo pikenisje

do të shërbejë për të ruajtur identitetin e Peshkopisë. Qyteti është i ndërtuar në të dy anët e një lugjeje gjë e cila u krijon banorëve ndjenjen e të qenurit të strehuar e të mbrojtur. Atmosfera në qytet e shpreh këtë ndjesi relaksimi dhe lirshmerie.

### Arkeologjia dhe vlerat historike :

Zona e Teqes është zona historike e qytetit. Në këtë pjesë të qytetit është prezent një stil specifik sa i takon ndërtimit dhe arkitektures. Në Peshkopi nuk ka ndërtesa të rregjistruara si ndërtesa historike dhe nuk kapasur ndonjë iniciativë që të paktën të jetë bërë e njohur, lidhur me mbrojtjen e ndërtësive shumë të bukura me vlera historike të cilat ndodhen në zonën e Teqes. Nisur nga pikepamja e interesave turistike dhe për hir të përmirësimit të identitetit lokal të Peshkopisë, do të ishte me rëndësi që të ruhej çështja e këtyre ndërtësive dhe të parandalohet prishja e metejshme e tyre. Prandaj është e nevojshme të hartohen rregullore të reja të cilat do të sigurojnë çështjet e mesipërme, rregullore të cilat do të përfshihen në planin rregullues të qytetit.

### Demografia :

Në Peshkopi jetojnë rreth 20.000 banorë shumica e të cilëve kanë lindur aty ose në fshatrat përreth. Gjatë 10 viteve të fundit numri i popullsisë është rritur me ritme të shpejta. Gjatë kësaj periudhe gjithnjë e më shumë banorë nga zonat rurale të Dibres kanë ardhur në qytetin e Peshkopisë. Aktualisht numri i banorëve të qytetit është stabilizuar për arsye se nuk ka më vend për të strehuar banorë të tjerë. Progresi i numrit të rezidentëve të Peshkopisë është paraqitur në tabelën




Tabela 01 Progresi i numrit të rezidentëve të Peshkopisë

Tabela 01 Numri i rezidentëve të Peshkopisë



Familjet ne Peshkopi jane me te vogla se ne zonat e tjera te Qarkut. Numri mesatar i banoreve per familje eshte akoma ne ulje. Ne baze te informacionit te zyres se statistikes prane bashkise, sic tregohet edhe ne tabelen 02, mund te nxirret perfundimi qe numri mesatar i banoreve per familje do te zvogelohet ne nje te ardhme te afert, sic po ndodh ne Europen Perendimore. Shifra me e re per nr mesatar te anetareve te nje familje (prill 2001) ne qytetin e Peshkopise eshte 3.73 banore per familje.

Popullsia	104.792	19.611
Numri i familjeve	24.161	5.178
Nr mesatar i banoreve per familje	4.34	3.79

Nje tregues tjeter interesant eshte forma e transferimit. U tha me lartqe banoret e fshatrave fqinje vijne ne Peshkopi dhe me te rinjte kryesisht shperngulen ne Tirane. Sipas shifrave te vitit 1999, rezulton qe kjo eshte pjeserisht e vertete. Duke pare shifren totale mund te arrihet ne kete perfundim. Por rritja e popullsise duhet pare vec e vec. Per Peshkopine rritja e numrit te banoreve eshte 1.4% kurse per pjesen tjeter te Qarkut rritja eshte 1.1%. Nqs ndjekim arsyetimin qe banoret e Peshkopise po levizin jashte Qarkut, kryesisht ne Tirane, dhe se te gjitha banoret qe vijne ne Peshkopi jane nga Qarku(579 banore), atehere numri i banoreve qe largohen plotesisht nga Qarku duke shkuar ne Tirane apo diku gjetke eshte 809(1957-579-569).Kjo mund te shihet edhe nga shifrat e dhjetorit 1997 dhe dhjetorit 1999. Numri i pergjithshem i popullsise se Qarkut u zvogelua me me shume se 13.000 banore, por numri i banoreve te Qytetit te Peshkopise mbeti i pandryshuar. Dhe keta 13.000 banore nuk mund te jene vetem nga qyteti i Peshkopise .

Ne tabelen 02 tregohet forma e transferimit si per ata qe vijne ashtu edhe per ata qe largohen nga qyteti.

Qarku Diber	Lindur	(e)migrante	Totali ardhur	Vdekur	Emigrante	Total larguar	bilanci
Qyteti Peshkopi	342	579	921	70	537	607	+ 314
Pjesa tjeter e Qarkut	1442	569	2011	310	1957	2267	- 256
<b>Totali Qarkun</b>	<b>1784</b>	<b>1148</b>	<b>2932</b>	<b>380</b>	<b>2494</b>	<b>2874</b>	<b>+ 58</b>

Bazuar ne keto shifra eshte e veshtire qe te parashikohen zhvillimet e mevonshme te popullsisë. Mund te pritët qe bilanci mes atyre qe e lene qytetin dhe atyre qe vijne aty, te ruhet. Por popullsia do te rritët nqs vazhdon i njejtë rritëm i larte lindjesh dhe nqs ekonomia do te permiresohet. Ne varesi te mundesive te permiresimit te situates se strehimit, rritja mesatare e popullsisë mund te jete 1.5-2% ne vit (300-400 banore ne vit).

#### Aspektet sociale dhe institucionet kulturore :

Ashtu si ne zonat e tjera te Shqiperise, migrimi nga zonat rurale drejt qytetit ka patur ndikimin e vet edhe ne jeten e komunitetit te qytetit te Peshkopise. Migrimi eshte sezonal dhe i perhershëm. 10% e popullates se zonave rurale migron ne zona te tjera gjate periudhes se veres: rreth 20% e se njejtës popullate, gjate dekades se fundit, ka migruar vazhdimisht drejt qyteteve. Levizja e pakontrolluar e popullates ka ndikimin e saj edhe ne fushen e urbanistikes. Peshkopia me pare ishte nje qytet i paster i dekoruar me peme e lule dhe me hapësira te gjelbra. Qe nga viti 1990 shume peme jane prere ndersa dyqanet e vogla dhe kioskat kane zene siperfaqet e gjelbra. Rritja e popullates ka sjelle edhe rritjen e sasise se plehrave, ndersa sherbimi i pastrimit publik nuk i ben dot balle kerkeses per pastrim.

Ne Peshkopi po funksionon nje pallat i ri kulture qe nga fillimi i vitit 2002 dhe aty krijohen mundesite qe qytetaret te organizojne aktivitate sociale te te gjitha llojeve. Pallati i sportit nuk ka perfunduar plotesisht prandaj ai nuk mund te perdoret. Fusha e futbollit eshte ne nje gjendje shume te keqe dhe duhet te rikonstruktohet. Nuk ka ambiente clodhese apo hapësira te gjelbra te medha ku njerezit mund te shetisin apo te merren me aktivitate clodhese.

#### Sherbimi shendetesor dhe arsimimi :

Kujdesi dhe sherbimi shendetesor kryesisht jane te organizuar nepermjet spitalit te Peshkopise i cili ka nje kapacitet prej 350 shtreterish.

2 kilometra jashte qytetit ndodhen llixhat ku vijne per t'u kuruar paciente me semundje reumatizmale. Ne lagjet Dobrove, Kamen, Gjok Doci dhe Nazmi Rushiti jane 5 klinika shendetesore dhe secila prej tyre ka nje mjek te pergjithshëm. Ne te gjithë qytetin ka rreth 10 klinika

dentare private. Peshkopia ka 4 kopshte ku shkojne rreth 150 femije, 3 shkolla 8 -vjecare me afro 2.500 nxenes dhe 2 shkolla te mesme me rreth 900 nxenes. Ne vitin 1999 numeroheshin 350 mesues ne Peshkopi. Shkolles se mesme i mungojne te gjitha ambientet e pershtatshme te nevojshme per permiresimin e kushteve te mesimit.

#### Ekonomia lokale dhe punesimi :

Qytetaret e Peshkopise po kalojne nje periudhe te veshtire per shkak te situates se varfer ekonomike. Ata mbijetojne duke u marre me bujqesi, duke u punesuar ne ndermarrje te vogla, apo hapur nje dyqan ose ofruar sherbime per qytetaret. Vec kesaj tregu i zi i punes eshte nje tjeter menyre mbijetese. Ne qytet s'ka vende pune te mjaftueshme per popullsine lokale, ndaj perqindja e papunesise eshte e larte. Ne 1999 papunesia ishte me e madhe se perqindja e te punesuarve. Sidoqofte shifrat e 1999 ishin me pozitive se ato te viteve te meparshme.

#### Strehimi :

Strehimi ne Peshkopi eshte kryesisht privat. Numri total i banesave nuk eshte i regjistruar. Sipas nje vleresimi te bere nga zyra per planifikimin e urbanistikes se qytetit del se aktualisht ne Peshkopi jane 3.250 shtepi banimi qe do te thote se ne cdo shtepi jetojne afro 1.8 familje. Numri i shtepive eshte me i vogel se numri i familjeve per shkak te kushteve ekonomike dhe pamundesise se njerezve per te blere shtepi, per shkak te bilancit te meparshem te migrimit dhe te tradites se vjeter shqiptare per te jetuar se bashku me prinderit ne nje familje te madhe patriarkale. Sidoqofte, shifra 1.8 duket shume e madhe per faktin se ka plot njerez te paperfshire ne kete shifer. Per momentin jane 750 familje te rregjistruara pa strehe dhe qe po presin per te m arre nje apartament. Ka shume prej ketyre familjeve qe jetojne me te afermit e tyre apo diku ne fshatrat fqinje , ne pritje te ndonje mundesie per te ardhur ne Peshkopi. Prandaj dhe eshte e nevojshme qe gjate fazes se ardhshme te projektit te behen llogaritje me te sakta ne menyre qe te jemi te afte te parashikojme nevojat per apartamente banimi ne te ardhmen. Zona e banimit tashme eshte percaktuar dhe ka nje siperfaqe prej 65 ha. Pothuajse te gjitha shtepite private te banimit jane ndertuar nga vete qytetaret. Gjate viteve te fundit shume shtepi jane ndertuar si prona private por pa leje ndertimi. Ato quhen ndryshe "ndertime pa leje". Per shtepite e



ndertuara pa leje nuk ka informacion te plote por eshte e ditur se jane pa leje dhe pa patur pronesi mbi token ku eshte ndertuar. Shtepite pa leje jane kryesisht pergjate rruges qe te con te llixhat dhe ne zonen e llixhave ne lindje te qytetit, dhe ne pjesen fundore te qytetit.

#### Infrastruktura :

Niveli i infrastruktures konsiderohet mesatarisht i keq. Eshte shume e rendesishme qe te permiresohet niveli i rrugeve dhe te gjitha rruget ne qytet te jene ne nivelin e rruges kryesore (bulevardit). Po ashtu ka nevojte te permiresohet edhe sistemi i kanalizimeve, vecanerisht te vihen kapaket e pusetave qe mungojne ne rruge dhe perbejne rrezik per kalimtarete. Furnizimi me uje te pishem tashme eshte bere i rregullt por persa i perket furnizimit me energji elektrike, ai le per te deshruar. Ne menyre qe te forcohet ekonomia dhe te sigurohet stabiliteti i nevojshem per kryerjen e sherbimeve publike, duhet qe furnizimi me energji elektrike te jete i vazhdueshem.

#### Parqet dhe zonat e gjelbra :

Ne fakt, Peshkopia eshte nje qytet i gjelberuar dhe me plot peme. Sidoqofte nuk ka parqe apo zona te gjelberuara ku njerezit mund te shetisin apo te kalojne kohen, te bejne shetitje me familjen dhe te clodhen. Per kete, atyre iu duhet qe te dalin me makine ne zonat perreth qytetit. Mungesa e zonave te gjelbra duhet riparuar sa me shpejt te jete e mundur. Keto zona te medha urbane te gjelbra jane shume te nevojshme per banoret ne menyre qe ato te kene mundesi te clodhen. Ky eshte kusht i rendesishem per terheqjen e turisteve ne qytet. Peshkopia ka nje mundesi shume te mire per nje park urban: behet fjale per luginen e gjelber te perroit, ndermjet Dodroves dhe qendres se qytetit.

#### Bujqesia :

Zona rrotull Peshkopise eshte e mirenjohur per prodhimet bujqesore dhe per prodhimin e frutave. Ngaqe ndermarrjet industriale te qytetit rane ne nje kolaps te plote, fermeret kultivojne prodhime vetem per nevojat e tyre dhe per te shitur dicka ne tregun lokal. Per momentin, ne Peshkopi nuk ka ndonje ndermarrje per perpunimin e prodhimeve bujqesore. Rritja e prodhimit bujqesor dhe te frutave, ka shume mundesi qe te behet biznesi baze ekonomik i qytetit.

Ne te shkuaren, ka pasur nje aktivitet shume intensiv per grumbullimin e bimeve mjeksore. Ekzistojne mundesite qe ky aktivitet te rigjallerohet.

### Industria dhe tregtia :

Industriete kryesore ne Peshkopi jane jashte funksionit per shkak te situates ekonomike. Ne vitin 1993 ishin rreth 60 ha ne perdorim per qellime ekonomike. Pjesa me e madhe e kesaj siperfaqe tani eshte e zhveshur ose perdoret ne menyre joeficente. Vecanerisht zona prane perroit e cila eshte prone private ka nevoje per rinovim. Edhe zona ne perendim te qytetit, ne rrugen per ne Kukes, duhet rinovuar menjehere. Do te ishte me vlere te studiohej nese ndermarrjet e vogla ekzistuese do te bashkoheshin me iniciativen per te ndertuar godina per bizneset e tyre pikerisht ne zonen ne dalje te qytetit dhe ta leshonin zonen ku kane ndertuar tani, zone e cila eshte e pershtatshme per te ndertuar banesa per qytetaret.

### Natyra dhe mjedisi :

Peshkopia ndodhet ne nje zone me natyre te mrekullueshme. Malet qe rrethojne qytetin jane te gjelberuara dhe ofrojne per qytetaret mundesi te mjaftueshme per aktivitete clodhese dhe fizike si p.sh. shetitje apo ngjitje ne mal. Dibra pershkohet nga Drini i Zi dhe nga rruga kryesore qe vjen nga Tirana drejt Bulqizes per te shkuar ne Kukes. Si Drini i Zi ashtu edhe rruga nacionale kalojne neper nje lugine te gjelberuar, ne te dy anet e se ciles shtrihen male te larta. Pas vitit 1990 zona e Dibres perjetoi nje ndryshim dramatik sa i takon marredhenieve mes njeriut dhe mjedisit. Si rrjedhoje e privatizimit ne favor te fermerëve, te nje siperfaqeje prej 12.000 ha toke bujqesore, nevoja per shtimin e siperfaqes se punueshme solli prerjen masive te pemeve qe ishin ne keto toka. Ne vend qe te kujdeseshin per nje marredhenie me afatgjate me mjedisin ku jetojne, fermeret kerkuan ta perdorin token per qellime afatshkurtra, gje qe solli prerjen masive te pyjeve. Eshte llogaritur qe cdo vit ne Diber zhduken rreth 150.000 m<sup>3</sup> lende druri, ndersa qe nga 1991 jane demtuar rreth 11.000 ha pyje. Kjo i sjell mjedisit ne Diber dhe vecanerisht mjedisit ne Peshkopi tre probleme kryesore: Erozionin e shkaktuar nga nderhyrjet e njerezve dhe nga shirat e shumta si dhe shperdorimin e ujit si rezultat i rritjes se prodhimtarise bujqesore. Cpyllezimin e shkaktuar nga prerja e pemeve per nevoja shtepiake dhe tregtare dhe per krijimin pa kriter te kullotave .Demtimet urbane te shkaktuara nga levizjet e popullates nga zonat rurale ne drejtim te qyteteve.

### Trafiku dhe transporti :

Trafiku dhe transporti ne Peshkopi jane te nje natyre tje ter. Aty mund te gjesh si trafikun e mjeteve te motorizuara ashtu edhe transportin me karroca te terhequra nga kuajt apo transportin me gomar. Pritet qe ne te ardhmen si pasoje e zhvillimit ekonomik dhe rritjes se mireqenies, trafiku i mjeteve te motorizuara te rritet. Por infrastruktura aktuale nuk eshte e pershtatshme per kete. Keshtu qe patjeter duhet qe te ndertohen rruge me cilesi dhe hapesira te mjaftueshme parkimi. Arsyeja tjeter per ndryshimin e politikave te transportit dhe trafikut ne Peshkopi eshte nevoja per t'i bere balle situates qe do te krijohet nga rritja e trafikut ne menyre qe ai te mos cenoje cilesine e jetes se qytetareve. Ceshtje tjeter qe kerkon pergjigje eshte se si te organizohet me mire transporti mes Peshkopise dhe fshatrave perre th, si dhe me qytetet e tjera. Aktualisht shoferet private po e organizojne kete transport ne menyre private, menyre e cila po funksionon mire ne situaten aktuale. Sidoqofte sistemi i transportit nuk ka cilesine e duhur per te patur nje lidhje te rregullt me Tiranen dhe me zonat e tjera per arsye biznesi dhe turizmi.

### Karakteristikat klimaterike :

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare para-malore meqënëse është pjesë e pellgjeve të lumenjve të Drinit. Dallohet për ndryshime të dukshme nga një sektor në një tjetër sidomos në drejtimin vertikal. Në formimin e kësaj klime kanë ndikuar faktorë si: lartësia dhe relievi i territorit, ndikimi i madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijnë nga grykat dhe qafat nga brendësia e ballkanit. si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër, dimër të gjatë dhe reshje të mëdha të dëbores dhe verë të freskët por pa reshje. Temperatura mesatare shkon nga 6 °C në malin e Korabit në 11 °C në afërsi të luginës. Po ta krahasojmë me temperaturën mesatare të vendit tona ajo leviz nga 4°C-8°C kuptohet që shkaku kryesor është lartësia mbi nivel të detit dhe pozicioni i saj lindor që kushtëzon një ndikim nga brendësia e ballkanit. Në periudhën prill-shtator temperatura mesatare është 16°C në afërsi të qytetit Për muajin korrik temperatura mesatare shkon nga 7 °C në pjesë të larta dhe 16 °C, në afërsi të luginës. Muaji janar është muaji më i ftohtë i vitit ku mesatarja shkon nga 0°C në -3°C. Amplituda e temperaturës vjetore merr vlera jo të vogla që shkojnë rreth 17°C-18°C. Kurse amplituda ditore shkon deri 10-15°C temperatura maksimale e zonës është rregjistruar në korrik të

1996 në qytet 39.5°C kurse ajo minimale është rregjistruar në 1959 kur ka arritur -20°C amplituda midis vlerave është relativisht jo e vogël që shkon 60°C. Data mesatare e fillimit të ngricave është 1 nëndori dhe data mesatare është 15 marsi. Numri mesatar i ditëve me ngrica shkon 136 dite kurse po ta krahasojme me zonat perendimore të vendit ajo është 40-45 dite. Numri maksimal

shkon 166 -190 në zonat me malore të kësaj zone që kemi marrë në studjum. Për sa i përket sasisë së rreshjeve zona futet në zonat nën masatën e vendit. Kjo vlerë shkon nga 900 mm (në qarrishte) ky ndryshim lidhet me deporimin e erave të ftohta e të thata. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në pjesën e ftohtë të vitit, 90 %, kurse në pjesën e ngrohtë bin rreth 10-15%, muaji më i lagët është nëndori me 12% të rreshjeve afro 225 mm, kurse muaji më me pak rreshje është korriku me 3.6% ose 46 mm. Maksimumi i rreshjeve në 24 ore ka qënë 127 mm. Për rreshjet e deboreve mund të themi se fillojnë mesatarisht me 1 nëndor dhe data e mbarimit është 20 mars. Numri mesatar i ditëve me borë shkon 38 dite dhe krijon një shtresë mesatare prej 30-35 cm. Shtresa maksimale shkon 1.5m në shpata të malit. Për sa i përket dukurive negative të klimës mund të themi se ajo ka karakter kapriçoz, pra ajo ka diktuar edhe vendosjen dhe mënyrën e ndërtimit në këtë rreth. Po ashtu kjo klimë që është edhe shumë e shëndetshme por nuk lejon kultivimin e të gjithallojeve të bimëve dhe me dukuri si: ngrica ta gjata dhe të vona, dorë të hërshme, rreshje të mëdha të borës dhe të breshërit, jo pak herë ka shkatërruar prodhimet bujqësore dhe i ka dhënë drejtim të gabuar zhvillimit ekonomik. Por kjo klimë ka edhe favorin e veta pasi lejon zhvillimin e disa llojeve të turizmit, si edhe të disa sektorëve të tjerë të ekonomisë.

### Hidrografia :

Ky rreth ka një rrjet hidrografik shumë të pasur që përbëhet nga lumaj, liqene përrejt, burime nën tokësore dhe mbi tokësore. Dega kryesore është lumi i Drinit të Zi që merr me vete disa degë të tjera si: Malla, Seta, Veleshica, Murra etj. Këta degë kanë karakter të vrullshëm dhe me prurje të mëdha në kohën e shkrirjes së borës. Gjë që i bën ata të jenë shumë të demshëm dhe të shkatërrojnë çdo gjë që u del para duke sjelle shumë materiale të ngurta e shkaktuar përmytje të tokave përreth.

Gjatësia dhe pellgu janë përkatësisht

Emri gjatësia në KM

pellgu në KM, Drini zi

57 530

Murra 19 135



Malla 18 126  
Seta 13 137  
Veleshica 15 84

Midis pasurive të shumta vlen për të përmendur edhe liqenet shumë të bukura të Lurës, burimin e llixhave si edhe disa burime të vogla në afërsi të qytetit, pasuritë hidrike kanë ndihmuar jo pak në zhvillim ekonomik të këtij rethi si në energji, ujë, peshkim, indrustri, etjer por këto burime shërbejnë edhe për terheqje të turistëve si për turizëm balnear, argëtues, pushues, eko turizem etj.

#### Bota shtazore :

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë sipas aspektit klimatik, atë të tokave, të nënës etj ka krijuar kushte shumë të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore shumë të larmishme. Këto gjë e dëshmon ekzistenca e shumë specieve të vecanta sipas karakterit të habitatit. Do të dallojmë botën shtazore të shkurreve, të pyjeve të ahut dhe të dushkut në lartësi botën interesante të kullotave alpine dhe të pak habitateve ujore. Në habitatet e shkurreve që janë me pak të zhvilluara e me pak të perhapura dhe të degraduara nga dora e njeriut gjëjmë: Lepuri i eger, çakalli, thelleza, dhe një sërë shpendesh të tjera. Në habitatet e dushkut që edhe ky kat është i demtuar takohen rrallë: Ujku, dhelpra, ketri, urithi, etj. Në habitatet e pyjeve të ahut dhe të pishës që janë me të dendura dhe me pak të prekura nga dora e njeriut takohen specie të vecanta: Ariu, Shqiponja, RRjepulli, miu vogël, urithi, etj. Në habitatet e ujërave të kthjellta dhe të ftohta të këtyre lumenjve takohet trofta e eger dhe disa lloje të tjera peshqish çka e bën këtë zonë të dallueshme nga zonat e tjera të vendit. E gjithë kjo, pasuri e botes shtazore dhe me vlera të vecanta ofron kushte për zhvillimin e disa llojeve të turizmit si : sportive, ekologjik, clodhes, etj

#### Blektoria :

Në këtë rreth kjo degë është shumë e rëndësishme dhe ka qënë gjithnjë baza e ekonomisë bujqësore në vitin 2003 në këtë rreth kemi 17266 krerë gjedhë, dhe 53010 krerë të leshta, në vitin 2003 çdo banori të Dibrës i takojnë 422 litra qumësht dhe 47 kg mish në vit. Indrustia në rrethin e Dibrës ka qënë gjithnjë një degë e dytë. Pas viteve 90 do të kemi një shkatërrim të atyre objekteve industriale që kishte, tani po vihet re një përmiresim i vogël në këtë drejtim në degë si industria ushqimore, ajo e përpunimit të produkteve bujqësore e blektorale si



edhe ajo e lëndëve të para për ndërtim. Objektet më të permendura janë fabrika e miellit, ajo e pijeve, disa lavatriçe rërash e zhavorësh, si edhe disa baxho. Në 2004 rethi i Dibrës kishte 808 subjekte private jo bujqësore, 8 hotele dhe restorante, 1 fabrikë mielli, 9 pika karburanti, 452 pika shumice, 1 qendër balneare, 38 ndërmarje druri, 138 furgone, autobuze dhe kamione transporti si edhe 89 ndërmarje shërbimesh.



## 1.2 - POZICIONI I OBJEKTIT

Zona ne te cilin shtrihet objekti i kontrates “ **Sherbim Projekt Zbatimi i objektit Permireshimi i Infrastruktures Vendore, Aksesit, Levizshmerise dhe Rivitalizim i hapësirave publike ne zonen prane Pallatit te Kultures** ” shtrihet në pjesën veriore te qytetit dhe ka një sipërfaqe rreth 2,7 ha.

Objekti që parashikohen të trajtohet në këtë detyrë projektimi perfshihen si pjese e territorit te Bashkise Diber, qyteti Peshkopi

## 1.3 – GJENDJA EKZISTUESE

**Rrjeti rrugor:** Gjendja e ketyre shesheve dhe rrugeve eshte tej e amortizuar dhe jasht cdo lloj standarti . nga pamundesia e fondeve keto sheshe dhe rruge nuk eshte mirmbajtur dhe ka degraduar ne gjendjen me te kete qe mundshme teper e amortizuar e jashte cdo standarti urban.

**Ujesjellesi:** Rrjeti i furnizimit me uje ne kete zone ekziston. Nga informacionet e marra edhe nga drejtoria e ujesjellesit paraqitet pa probleme .

**Objekt i projektit:** Eshte permireshimi i Infrastruktures Vendore, Aksesit, Levizshmerise dhe Rivitalizim i hapësirave publike per rreth 4000 banore te qytetit dhe arterie lidhese me fshatrat perreth.

## 1.4 – STUDIMI TOPOGRAFIK

Zona ne te cilin shtrihet objekti i kontrates “ **Sherbim Projekt Zbatimi i objektit Permireshimi i Infrastruktures Vendore, Aksesit, Levizshmerise dhe Rivitalizim i hapësirave publike ne zonen prane Pallatit te Kultures** ” shtrihet në pjesën veriore te qytetit dhe ka një sipërfaqe rreth 2,7 ha. Per hartimin e projektit dhe per nxjerrjen e nje serie te dhenash jane shfrytezuar hartat topografike te zones ne shkallet 1:25.000 dhe 1:10.000, fotot ajrore dhe satelitore te zones si dhe matjet e drejtperdrejta ne terren.

**Hartat bazë te perdoruar ne shkalla 1:25.000 janë:**

Harta me Nomenklature K-27-087-D-c

Harta me Nomenklature K-27-087-D-d

**Hartat bazë te perdoruar ne shkalla 1:10.000 janë:**

Harta me Nomenklature K-34-087-D-c-4

### **Punimet Gjeodezike**

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin " **PERMISIMI I INFRASRUKTURES VENDORE DHE RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN PRANE PALLATIT TE KULTURES** " u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te

parashikuara nga Investitori. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojës se perftuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjithë projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit. Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projeksioni Gauuss Kryger-it me ellipsoid Krasovsky-n.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me goxhde betoni te ngulura ne objekte betoni. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrushme, ne ane te rruges ose afer saj, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e objektit qe perfshihen ne projekt.

Matjet u kryen me GPS TRIMBELL R6, Stacion Total te tipit Leica 307, Stacion Total te tipit Trimble M3 si dhe me nivele, te cilet teknikesht siguron matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve.



**Leica 307  
TOPCON GPT 900 A**



**Trimble M3**



**TRIMBELLR6**

**DINI LEVEL**



**GPS TRIMBELL R6**

### **Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik**

Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rievuese, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithe sektoret e rruges dhe shesheve.

Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti. Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm.

### **Rilevimi**

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua procesi i matjeve topografike

Eshte rilevuar ne menyre te plote e gjithë siperfaqja e zones ku shtrihet objekti si dhe e nje brezi perimetral qe e qarkon ate. Ne relief jane pasqyruar ne menyre te plote te tere elementet perberes te tij, kanale, puseta, platforma betoni, shtylla ndricimi ose tensioni, bunkere, tombino, trotuare, ura, ndertesa, objekte te ndryshem, rruge kryesore e dytesore, perrenj, nje numer i dendur pikash detaje etj. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik e te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt. Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin STRATO dhe LEONARDO, TGO, Autocad Land Development nga ku eshte perftuar rilievi tre dimensional i objektit. Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e pikave poligonale dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

### **Pershkrimi i punes ne terren.**

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijua bazamenti gjeodezik ne formen e nje poligoni te hapur (pika te forta) te cilat jane te mjaftueshme per marrjen (matjen) e pikave detaje te rilevimit. Matja e ketyre pikave u kryen me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave.

Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Keshtu per pikat deri ne 1km nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 2 km intervali 15 sek. Element kryesor ne matjen 'stop&go' eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmatur futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit TRIMBLE R6 japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar.

Ne zonat me dendesi ndertimesh u perdor Stacioni Total pasi kishte peme dhe ndertime te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.



## 1.5 – STUDIMI GJEOLO-INXHINIERIK DHE HIDROLOGJIK

### 1. HYRJE

Ne Qershor 2014 , u krye studimi gjeologjik i rrugeve te bllokut per objektin e kontrates " **PERMISIMI I INFRASRUKTURES VENDORE DHE RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN PRANE PALLATIT TE KULTURES** " per fazen e projekt zbatimit sipas variantit te pergatitur nga grupi i projektimit. Studimi eshte kryer sipas materialeve topografike te pregatitura.

Per rruget e bllokut te siperpermendur jane kryer punimet e meposhtme:

1. Studimi i themelit te rrugeve
2. Studimi i vendeve ku ka mbushje ose germime me permasa te medha
3. Studimi i materialeve te ndertimit

### 1.2 Qellimi i studimit

Destinacioni i ketij studimi eshte percaktimi i karakteristikave fiziko mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne zonen ku kalojne rruget e ketij blloku, per fazen e projektit te zbatimit. Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do ti sherbejne projektuesve per te realizuar projektin e shtresave te rrugeve, projektin e ujesjellesit , kanalizimeve, etj. Ne kete studim do te percaktohen vendet dhe karakteristikat e materialeve te ndertimit qe jane te nevojshme per ndertimin e ketyre rrugeve

### 1.3 Objektivi i Punimeve

Shkurtimisht raporti shqyrton ceshtjet e meposhtme te cilat do te jene te mbeshitura me punimet gjeologjike sipas programit te hartuar.

1. Jane rishikuar te gjitha punimet e meparshme gjeologjike te kryera nga autoret dhe nga autore te tjere vendas te cilat jane kryer per qellime te tjera por kane vlera njohese. Jane shikuar te gjitha studimet e botuara dhe te pa botuara per zonen ne fjale.
2. Jane studiuar punimet gjeologjike te vjetra qe jane kryer per kete rruge hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike te zones.
3. Jane kryer punime te ndryshme sipas programit te hartuar me siper, por te kombinuar dhe me punimet ekzistuese te cilat jane shume te rendesishme per te kuptuar fenomenet gjeologjike qe kane ndodhur ne zhvillimin e historikut gjeologjik te kesaj zone.
4. Nje rendesi te vecante kane dhe testimet ne laborator te kampioneve te marre ne terren nga shpimet dhe gropat

Studimet jane kryer konform standarteve qe jane paraqitur ne dokumentat e tenderit sic jane: ASTM.AASHTO.EN .BSI. UNI.

## 2.0 GJEOMORFOLOGJIA

Ne kete kapitull behet pershkrimi i zones ku shtrihen rruget e bllokut; format e relievit te sotem dhe te hershem, kushtet gjeologjike te formimit te ketij relievi. Do te behet pershkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

## 2.1 Vendodhja e zones ku shtrihet objekti.

Zona ne te cilin shtrihet objekti i kontrates Studim-Projektim **PERMISIMI I INFRASRUKTURES VENDORE DHE RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN PRANE PALLATIT TE KULTURES "**

Zona ku shtyrihet projekti eshte me origjine aluviale ne te jane prezente dhe depozitimet e fraksioneve te imta te pakonsoliduara te cilat kane permbajtje te lendes organike. Nen keto depozitime takohen shkembinjte Neogjenike qe perbehen nga argjilite dhe ranore. Depozitimet Neogjenike kane trashesi 100-250m.

## 2.2 Proceset fiziko gjeologjike dhe gjeodinamike

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi aktual. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qe takohen ne kete zone.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

### 1. Fenomeni i perajrimit

### 2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje me poshte:

**1. Fenomeni i perajrimit** eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite, keto shkembinj jane depozitime te reja dhe me cimentim te dobet argjilor, ato nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet me teper ne pjesen kodrinore te zones sic jane kodrat e Dajtit Paskuqanit dhe kodrat e Selites.

**2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale.** Keto depozitime perbehen nga shtresa suargjilash, surerash zhavore dhe argjilash me permbajtje lendesh organike . Shtresat qe permbajne lende organike jane te pakonsoliduara ose pak te konasoliduara. Ne sheshin e studiuar nuk jane takuar shtresa te tilla, por neqoftese do te takohen gjate zbatimit te punimeve duhet te konsultohet situata me projektuesin dhe me gjeologun e punimeve. Niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes.

## 3.0 NDERTIMI GJEOLGJIKE DHE HIDROGJEOLGJIKE

Bazuar ne materialin e grumbulluar po shtjellojme kushtet gjeologjike te ndare ne studimet ekzistuese dhe ne studimet e reja te kryera nga grupi i studimit.

### 3.1 Studimet Ekzistuese

Ne zonen ne fjale, jane kryer shume studime rajonale dhe lokale. Keto studime jane kryer per projektimin e themeleve te godinave te reja qe jane ndertuar ne kete zone .

Ne kete zone jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuaternarit

### 3.1 Depozitimet e Kuaternarit (Q<sub>4</sub> pl +al)

Depozitimet aluvialo eluviale perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te renda ,surera rera zhavore dhe argjila. Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara, takohen ne gjithe zonen ne pjesen siperfaqesore

dhe ka trashesi 10.00-12.00m. Keto depozitime sic e kemi permendur jane pak deri te pakonsoliduara me permbajtje te lendes organike sidomos surerat dhe argjilat me permbajtje te lendes organike. Ne kete zone niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes dhe ka patur kushte per tu konsoliduar ne menyre natyrore. Prezenca e lendes organike ka zgjatur kohen e konsolidimit te ketyre depozitimeve. Nderthurja e depozitimeve me depozitimeve te perrejve perrreth ka bere qe shtresat te jene ne formen e linzave shume heterogjene dhe ta veshtiresojne identifikimin e tyre.

### **3.3 Depozitimet e Neogjenit ( $N_1^{2t}$ )**

Nen depozitimet e Kuaternarit takohen depozitimet e Neogjenit qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyre gri me çimentim te dobet deri mesatar, pjesa e siperme e ketyre depozitimeve eshte e perajruar.

#### **Kushtet Hidrogjeologjike**

Nga studimet e kryera ne zone, rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndyshem. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja ne to jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithë periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor nuk eshte shume afer siperfaqes se tokes (-2.5m). Ne Vere, ky nivel eshte me i thelle nga siperfaqja e tokes natyrore sesa niveli i ujit ne Dimer.

Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra neutrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

## **4.0 PUNIMET FUSHORE**

Per percaktimin e kushteve te detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike te zones ku do te ndertohet, eshte hartuar nje program i detajuar i cili eshte respektuar gjate studimit ne fjale.

### **4.1 Qellimi i Punimeve Fushore**

Punimet fushore kane per destinacion te percaktojne ne terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike ne zone. Ne fazen e punimeve fushore jane marre dhe kampionet me strukture te prishur dhe te paprishur per tu analizuar ne laborator. Ne kete faze jane identifikuar dhe fenomenet negative fiziko - gjeologjike qe jane prezente ne kete zone.

### **4.2 Inspektimi i Punimeve ne Terren**

Te gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike dhe shpimet jane kryer nen mbikqyrjen e rrepte te inxhinierit gjeolog . Inxhinieret, kane mbajtur te gjitha shenimet fushore te cilat jane krahasuar me te dhenat laboratorike. Mbi bazen e te dhenave te korektuara nga pershkrimi fushor dhe rezultatet laboratorike eshte bere perpilimi i Raportit Gjeologjik.

### **4.3. Planifikimi i Thellesise se Shpimeve dhe gropave si dhe Caktimi i Tyre ne Terren**

Para fillimit te punes ne terren eshte bere studimi i draftit te projektit te detajuar mbi bazen e te cilit jane projektuar punimet fushore.

Per te vleresuar kushtet gjeologjike te zones ku do te ndertohen, per kete faze studimi jane parashikuar te hapen disa grupa me thellesi 2.50-3.00m

### **4.4 Gropat**

Sipas programit te aprovuar, per bllokun ne fjale, jane hapur gropa me thellesi 2.50-3.0m sipas akseve te rrugeve.

#### **4.4.1 Metoda e germimit**

Gropat jane germuar me eskavator te vogel ne pikat e percaktuara behej germimi gropes, mbasi behej germimi ne faqet e pastra te tij behej pershkrimi shtresave gjeologjike dhe mereshin kampinet per ne laborator. Gropat germohen ne prezence te inxhinierit gjeolog i cili drejtonte manovratorin per menyren e kryerjes se punes.

#### **4.4.2 Marrja e Kampioneve**

Marrja e kampioneve ne gropa eshte kryer si me poshte; mbasi behej germimi i gropes deri ne thellesine 2.50-3.00m dhe identifikohet numri i shtresave qe takohet ne prerjen e gropes merrej kampioni per te matur lageshtine natyrore per secilen shtrese i cili futej ne nje bukse per te ruajtur lageshtine deri ne laborator. Matja e lageshtires eshte bere dhe ne terren me aparaturen e matjes se lageshtires ne terren neqoftese ajo ishte me e vogel se 15%, per rastet e tjera shkonte ne laborator. Sipas rastit qe varej nga numri i shtresave qe takoheshin merrej kampione ne thase plastike me peshe deri 25-30kg. per secilin thes vendosej etiketa me adresen e pitit dhe me thellesine perkatese. Kampioni merrej duke i vecuar ne faqen e pusit shtresat dhe behej germimi i ri per marrjen e kampionit pa u perzier me shtresat e tjera

#### **4.4.3 Matja e Nivelit te Ujit Nentokesor**

Mbasi mbaronte germimi pit , pershkrimi i shtresave dhe marrja e kampioneve, gropa lihej hapur per disa ore per te pritur grumbullimin e ujit dhe per te matur nivelin e tij.

### **5. ANALIZAT LABORATORIKE**

#### **5.1 Qellimi i provave**

Sipas programit te hartuar, jane kryer testimet laboratorike te mostrave te marre ne zonen ku do te kalojne rruget e bllokut. Ne laborator jane kryer testimet per te percaktuar karakteristikat fiziko – mekanike te llojeve te dherave dhe te shkembinjve, te cilat ishin me strukture te prishur dhe te paprishur. Keto kampione jane marre nga shpimet, gropat ne akset e rrugeve dhe gropat per materialet e ndertimit.

Keto procedura qe jane konform manualit te cilesise EN ISO 9001 – 2008 dhe manualit te cilesise EN ISO 17025-2006 garantojne cilesine dhe saktesine, si dhe nje raport te plote e te hollesishem te provave te kryera.

#### **5.2 Percaktimi i struktures se kampionit,ngjyres dhe fortesise**

Per klasifikimin e kampioneve te testuara eshte ndjekur nje procedure rigoroze ku cdo kampioni i eshte vendosur nje targe perkatese sipas te ciles identifikohet plotesisht origjina e kampionit, vendmarrja, thellesia dhe te gjitha hollesite e tjera te nevojeshme. Kampionet e mberritura ne laborator jane ruajtur me kujdesin maksimal, ne temperature dhe lageshti ne menyre qe te mos kishte ndryshime te karakteristikave te tyre origjinale.

#### **5.3 Testimet e Dherave**

##### **5.3.1 Testimet Standarte**

Ne kemi pershkruar me siper menyren e kryerjes se analizave te identifikimit te llojeve te dherave qe kane mberritur ne Laborator si dhe standartet e perdorura. Provat jane kryer bazuar ne standardet BS (British Standard, ASTM, AASHTO, UNI ) ne cdo certificate te testeve jane te shenuar dhe



standartet e perdorura per realizimin e proves. Paisjet qe disponon laboratory jane te pershtatshme per te kryer testimet sipas standardeve te mesiperme.

## **6.0 REZULTATET E STUDIMIT NE TERREN DHE NE LABORATOR**

Ne kete kapitull do te trajtohet interpretimi i rezultateve te studimit gjeologjik dhe gjeoteknik qe eshte kryer ne bllokun ne fjale.

### **6.1.1 Gjendja e rrugeve ekzistuese te bllokut**

Per te vleresuar gjendjen e rrugeve ekzistuese konturuese te bllokut, jane bere disa rikonjucione dhe rezulton se nje pjese e tyre jane ne gjendje natyrore. Edhe ato rruge qe jane te shtruara, kane deformime dhe demtime shtresash. Ne disa pjese jane bere riparime, por pa efektivitet. Te gjitha demtimet kane ardhur nga mirembajtja jo e mire e tyre, nga cilesia e dobet e punes dhe nga hapja kohe pas kohe e kanalizimeve te ndryshme. Kjo gjendje e rrugeve kerkon nje projektim te detajuar te tyre dhe rikonstrukcionin e tyre sipas kushteve teknike.

### **6.1.2 Identifikimi i problemeve gjeologjike ne rruget e bllokut**

Ne perputhje me programin e studimit ne kemi kryer teste ne terren dhe ne laborator per te vleresuar kushtet gjeoteknike dhe gjeologjike te zones ku kalojne rruget e bllokut .

#### **➤ Analiza e rezultateve te gropave qe jane kryer ne zonen ku kalon**

#### **aksi i rrugeve.**

Per te vleresuar rruget ekzistuese ne çdo 350 m ne krah te segmenteve dhe ne sheshin e ndermjetem, jane hapur gropa deri ne thellsine 2.50m, jane marre kampione per cdo shtrese. Kampionet jane derguar ne laborator dhe jane bere analizat e identifikimit te dherave te ngjeshmerise dhe te kapacitetit mbajtes CBR

### **6.2. Karakteristikat fiziko mekanike te shtresave gjeologjike qe takohen ne zonen e rrugeve.**

Per akset e rrugeve dhe ne zonen e sheshit qendror, jane kryer ne terren dhe ne laborator punime gjeologjike te cilat kane vleresuar cilesite fiziko mekanike te shtresave qe takohen ne gjithe aksin e rruges. Meqenese ato jane te vazhdueshme per gjitha rruget, jane vecuar disa shtresa te cilat paraqiten ne vijim:

***Shenim: Duhet theksuar qe studimi ne fjale eshte realizuar mbi kampionet e marra ne gropat me thellesi 2.5-3m. Per te patur nje informacion me te plote mbi karakteristikat e nenshtresave, ne vijim jane dhene parametrat e shtresave per thellesi me te madhe sesa 3.0m. Ky informacion shtese eshte mbeshtetur ne studime e tjera (ne shpime) te kryera nga ana jone apo edhe nga te tjere mbi objektet e banimit ndertuar vitet e fundit ne zone.***

#### **SHTRESA Nr.1.**

Perfaqesohet nga toka vegjetale dhe dhera te hedhura, te cilat perbehen nga suargjila te mesme, me bezhe ne kafe, permabjne rrenje bimesh



dhe copa tullash. Vende - vende jane te ngjeshura dhe pjese te tjera jane pak te ngjeshura. Takohet ne thellesite; 0.30-0.70m.

**SHTRESA Nr.2**

Perfaqesohet nga suargjila te mesme me ngjyre kafe ne te kuqerremte me lageshtire dhe ne gjendje plastike. Permbajne guriçka te vogla dhe rralle zaje zhavori. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohet deri ne thellesite; 3.20-4.00m

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

**Perberja granulometrike**

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	40.30 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	35.70 %
Fraksioni rere	> 0.075 mm	24.00 %

**Plasticiteti**

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 39.50 \%$
Kufiri i poshtem i plasticitetit	$W_p = 23.30 \%$
Numri i plasticitetit	$F = 16.6$
Lageshtia natyrore	$W_n = 26.30 \%$
Pesha specifike	$\delta = 2.70 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.95 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit	$\epsilon = 0.72$
Grada e lageshtise	$G = 0.94$
Moduli i deformacionit	$E = 99 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\phi = 21^\circ$
Kohezioni	$C = 0.24 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.99 \text{ kg/cm}^2$

**SHTRESA Nr.3**

Perfaqesohet nga suargjila te lehta zhavorore me ngjyre kafe ne bezhe me lageshtire plastike. Permbajne shtresa te holla surere dhe rere me trashesi 15-20cm. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohet deri ne thellesite; 7.40-7.90m

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

**Perberja granulometrike**

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	15.40 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	26.20 %
Fraksioni rere dhe zhavor	> 0.075 mm	58.40 %

**Plasticiteti**

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 30.20 \%$
Kufiri i poshtem i plasticitetit	$W_p = 24.30 \%$
Numri i plasticitetit	$F = 6.1$
Lageshtia natyrore	$W_n = 24.50 \%$
Pesha specifike	$\delta = 2.66 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.97 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit	$\epsilon = 0.67$
Grada e lageshtise	$G = 0.91$
Moduli i deformacionit	$E = 157 \text{ kg/cm}^2$

Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 26^{\circ}$
Kohezioni	$C = 0.12 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 2.10 \text{ kg/cm}^2$

## 7.0 RAPORTI MBI MATERIALET E NDERTIMIT

Per ndertimin e rruges jane te domosdoshme materialet qe do te sherbejne per mbushjet e rruges. Materialet per prodhime e shtreave granulare, per prodhimin e betoneve dhe te asfalteve. Jane studiuar te dy tipet e materialeve dhe jane vleresuar dhe sasite e tyre.

Ne studimin e karierave jane patur parasysh disa pika te rendesishme si:

1. Qe vendet e tyre te jene sa me prane objektit qe do te ndertohet
2. Te shfrytezohen ne maksimum karierat ekzistuese qe jane prane bllokut
3. Gjate shfrytezimit te karierave te ruhet ambienti nga ndotja dhe te mos prishet peisazhi natyror.
4. Materialet te plotesojne cilesite teknike sipas standartit qe eshte projektuar kjo rruge.
5. Jane bere studime per materialet qe do te krijohen nga germimet per ndertimin e rruges dhe dy kariera shkembore.

Nga studimi gjeologjik i zones shkembinjte me karakteristika me te mira per tu perdorur si materiale ndertimi jane shkembinjte gelqerore.

### 7.1 Karierat qe do te perdoren per mbushjet e trupit te rruges.

Zona ku eshte kryer studim eshte e pasur me materiale ndertimi. Per mbushjet e ndryshme te trupit te rruges jane studiuar materiale qe jane brenda kesaj zone.

### 7.2 Kariera qe do te perdoren per prodhimin e shtresave te mbistrutures se rruge dhe per prodhimin e asfaltit e betoneve te ndryshme.

Per keto tipe materialesh jane studiuar dy kariera qe jane me afer trupit te rruges. Karierat e ne afersi te Peshkopiit perbehen nga shkembinj te forte gelqerore qe plotesojne kushtet per tu perdorur per prodhimin e betoneve dhe te asfalteve. Jane kariera ekzistuese.

Per shtresen konsumuese te asfaltit (tapeti) ne rekomandojme te perdoren shkembinjte basalte qe takohen ne zone, ato jane shkembinj te forte dhe jetegjatesia e rruges nga 5-6 vjet qe eshte neqoftese perdorim gelqerore me bazalte eshte 15-20 vjet.

## 8.0 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Ne sheshin e ndertimit takohen depozitimet e Kuaternarit (Q<sub>4al+el</sub>) qe perfaqesohen nga suargjila, surera, rera dhe zhavore si dhe depozitimet Neogjenike qe perbehen nga argjilite, ranore, konglomerate.
2. Niveli i ujit nentokesor eshte -2.5m nga siperfaqja e tokes. Jane ujra neutrale , ato nuk jane agresive.

3. Rekomandojme qe te ne rast se gjate germimeve, do te takohet ndonje shtrese me karkateristika te ndryshme me studimin e dhene duhet te merret mendimi i gjeologut dhe projektuesve per kalimn e situates.
4. Rekomandojme qe materialet e krijuara nga germimet te mos perdoren per mbushjet e trupit te rruges sepse jane me perberie argjilore.
5. Problemet kryesore gjeoteknike qe duhen zgjidhur ne kete rrjet rrugor jane
  - o ndertimi i trupit te rruges sipas kushteve teknike me materiale te cilesise se larte
  - o ndertimi i drenazheve dhe tubacioneve ne menyre qe uji te mos kaloje ne trupin e rruges.
6. Materialet e ndertimit per mbushjet e ndryshme te merren ne zonen e Peshkopiit. Per shtresen konsumuese te rruges te perdoren material lumore ose materiale bazalte nga shkembinjte magmatike te zones Mirdita

## 1.6 – STUDIMI HIDROLOGJIK, KUSHTET KLIMATIKE DHE HIDROLOGJIKE

### 1. Hyrje

Sipas ndarjes administrative, zona përfshihet në territorin e Bashkise se Dibres,qyteti Peshkopi

Në aspektin klimatik zona në studim ndodhet në nënzonën klimatike mesdhetare fushore nën ndikimin dhe të detit Adriatik.

Temperatura mesatare e Janarit, muajt më të ftohtë të vitit, arrin deri në 6°C. Gjatë Korrikut dhe Gushtit temperatura mesatare e ajrit arrin deri në 24°C kurse temperatura mesatare shumëvjeçare arrin deri në 15°C. Reshjet mesatare shumëvjeçare arrijnë deri 1280 mm dhe reshjet maksimale kanë arritur deri 257 mm në 24 orë.

Aktualisht e tere zona sot është kthyer në një rajon te mirefillte urban.

Të dhënat mbi reshjet janë marrë nga burimet arkivale të Institutit Hidrometeorologjik të Peshkopise per zonen e qytetit dhe botimet periodike të tij.

Autorët e studimit kanë shfrytëzuar gjithë punimet ekzistuese dhe punimet e reja në rajonin dhe janë kryer matje gjatë periudhës së studimit të zonës dhe janë nxjerrë rezultate përfundimtare për llogaritjet hidrologjike.

Tabela Nr. 1 Parametrat klimatik të zonës në studim.  
Vendmatja meteorologjike Peshkopi

	Emërtimi	Peshkopi
1	Temperatura mesatare vjetore, °C	15.1
2	Temperatura mesatare më e lartë në verë, °C	23.0
3	Temperatura më e lartë absolute, °C	41.5
4	Temperatura mesatare më e ulët në dimër, °C	7.6

5	Temperatura më e ulët absolute, °C	-1.4
6	Reshjet mesatare vjetore, mm	1210
7	Reshjet maksimale vjetore, mm	1756
8	Reshjet minimale vjetore, mm	860
9	Reshjet më të mëdha 24 orëshe	237
10	Zgjatja faktike e diellzimit në orë, vjetore	2532
11	Drejtimi mbizotërues i erës vjetore	S.E 15.8
12	Mbizotërimi i drejtimit të erës në verë	N.W 20.6
13	Mbizotërimi i drejtimit të erës në dimër	S.E 22.5
14	Shpejtësia mesatare e erës, m/sek	1.6
15	Presioni bazë i erës, kg/m <sup>2</sup>	0.281
16	Thellësia maksimale e borës, cm	20
17	Thellësia e ngrirjes së tokës në cm	10
18	Lagështia relative mesatare, %	70
19	Avullimi mesatar	800, 600
20	Numri mesatar i ditëve me reshje $\geq 0.1$ mm	130
21	Numri mesatar i ditëve me reshje $\geq 1$ mm	103
22	Numri mesatar i ditëve me reshje $\geq 5$ mm	64
23	Numri mesatar i ditëve me reshje $\geq 10$ mm	43
24	Intensiteti i tërmeteve në studim (Magnituda max. e pritshme Botim 1998 Harta me zona sizmike me rrezik potencial të mundshëm. Sh. Aliaj)	5-6

## KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

### 2.1 Temperatura e ajrit

Paraprakisht duhet vënë në dukje se e gjithë ultësira bregdetare (ku ndodhet edhe zona në studim) gjendet nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik. Ndikimi i tij shprehet në vlerat mesatare të temperaturës së ajrit, në minimumet dhe maksimumet absolute të tyre të cilat ndikojnë në strukturat ndërtimore. Një nga parametrat më të rëndësishëm të temperaturës së ajrit është temperatura mesatare e tij. Në tabelën Nr.2 jepen temperaturat mesatare mujore të vendmatjes meteorologjike Peshkopi.

Tabela Nr. 2 Temperatura mujore dhe vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes
Peshkopi	6.9	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2	15.1

Temperatura e ajrit




Fig. 1 Shpërndarja brendavjetore e temperaturës mesatare të ajrit, stacioni Peshkopi

Tabela Nr. 3 Temperatura maksimale absolute

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Peshkopi	21.3	27.7	29.6	31.7	35.8	37.9	35.8	37.9	41.5	31.4	26.9	22.5	41.5

Tabela Nr. 4 Temperatura minimale absolute

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Peshkopi	-10.4	-7.6	-7.0	0.0	1.8	5.6	9.4	10.0	3.8	-1.3	-6.1	-6.9	-10.4

Tabela Nr. 5 Numri i ditëve me temperaturë  $\leq 0^{\circ}\text{C}$ 

Nr	Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
1	Peshkopi	10.3	5.5	3.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	3.4	8.6	32.2

Tabela Nr. 6 Numri i ditëve me temperaturë  $\leq -5^{\circ}\text{C}$ 

Nr	Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
1	Peshkopi	0.9	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	1.9

Nga analiza e temperaturave mesatare të ajrit dhe të vendmatjeve meteorologjike në periferi të zonës në studim, vihet re se kemi të bëjmë me një zonë pak a shumë homogjene nga ana termike. Për sa i përket luhatjes brenda vitit të temperaturës së ajrit duhet thënë se kemi të bëjmë me një regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vërehet në muajin Janar,  $6.9^{\circ}\text{C}$  ndërsa temperatura maksimale vërehet në periudhën Korrik-Gusht  $23.8^{\circ}\text{C}$ .

Në projektimin e rrugëve, rëndësi paraqet gjithashtu edhe numri i ditëve me temperaturë nën  $-10^{\circ}\text{C}$  që quhen ditë të akullta. Në zonën në studim, ditë të tilla janë tepër të rralla dhe në tabelën Nr. 6 janë dhënë temperaturat nën  $-5^{\circ}\text{C}$  dhe janë vërtetuar vetëm dy ditë me temperaturë nën  $-5^{\circ}\text{C}$ .

## 2.2 Reshjet atmosferike



Reshjet atmosferike janë një nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të zonës në studim. Në rastin e projektimit të një rruge apo më tepër të blloku të tere, veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhet direkt me mbrojtjen e rrugës si dhe me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse nga njera ane si dhe me kushtet e jetesës së banoreve nga ana tjetër.

Në tabelën Nr. 7 jepen veçoritë kryesore të reshjeve mujore dhe vjetore për vendmatjet meteorologjike

Tabela Nr. 7 Reshjet mujore dhe vjetore

Nr	Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
1	Peshkopi	135	126	113	102	92	63	38	45	84	111	162	141	1210
2	Burrel	156	182	180	151	113	123	50	61	124	156	194	190	1670

Siç shihet nga të dhënat e tabelës nr. 7 zona në studim ka vlera afërsisht të barabarta. Këto vlera janë nën mesataren e territorit të vendit tonë e cila arrin në vlerën 1450 mm.

Për sa i përket shpërndarjes brendavjetore të reshjeve atmosferike bie në sy se sasia më e madhe e tyre, rreth 83%, bie në periudhën tetor-maj që në vendin tonë konsiderohet periudha më e lagët e vitit. Muaji me reshje më të larta gjatë viti është muaji nëntor.

Tabela Nr. 8 Vitet me reshje vjetore maksimale dhe minimale dhe raporti ndërmjet tyre

Nr	Vendmatjet	Reshjet maksimale		Reshjet minimale		Raporti
		Sasia në mm	viti	Sasia	Viti	
1	Peshkopi	1756	1937	860	1943	2.00
2	Burrel	2330	1981	937	1973	2.47

Duke bërë analizën e të dhënave meteorologjike mbi reshjet maksimale dhe minimale dhe vitet përkatëse të rënies së tyre, shikojmë se raporti midis reshjeve maksimale dhe minimale është rreth 2.0. Gjithashtu konstatojmë nga materiali shumëvjeçar se periudha 1940-1950 është periudha me më pak reshje, kurse periudha 1960-70 me më shumë.

Në projektimin e rrugëve përveç reshjeve mujore dhe vjetore, rëndësi paraqet edhe shpeshësia e shfaqjes së reshjeve të vogla si 0.1 mm, 1.0 mm, dhe 10.0 mm.

Për këtë qëllim janë llogaritur për gjithë periudhën e dhënë për vendmatjet meteorologjike Peshkopi dhe Peshkopi, numri i ditëve me reshje  $\geq 0.1$ mm, me reshje  $\geq 1.0$ mm dhe me reshje  $\geq 10.0$ mm të cilat paraqiten në tabelën Nr. 9.

Tabela Nr. 9 Karakteristikat më të rëndësishme të reshjeve

Nr	Vendmatja	Numri i ditëve			
		me reshje $\geq 0.1\text{mm}$	me reshje $\geq 1.0\text{mm}$	me reshje $\geq 5.0\text{mm}$	me reshje $\geq 10.0\text{mm}$
1	Peshkopi	133	103	64	43
2	Burrel	131	112	66	58

Një parametër tjetër i rëndësishëm i reshjeve atmosferike janë dhe intensiteti i tyre për intervale kohe të ndryshme. Një nga intervalet kohore më karakteristik janë ato 24 orëshe.

Duke pasur parasysh sasinë e reshjeve për intervale kohore nga 10 minuta deri në 24 orë në periudha të ndryshme kthimi (return periods). Kjo zonë karakterizohet nga intensitete relativisht të larta.

Tabela Nr. 10 Intensitetet e reshjeve nga 24 orë deri në 10 minuta me siguri të ndryshme për vendmatjen meteorologjike Peshkopi

Emërtimi	1%	2%	5%	10%	20%
Reshjet 24 orëshe	181	164	142	125	107
Reshjet 12orëshe	169	152	129	11	93
Reshjet 6 orëshe	130	117	100	87	73
Reshjet 2 orëshe	87	79	68	60	51
Reshjet 1 orëshe	74	67	57	49	42
Reshjet 30 min	50	46	39	34	30
Reshjet 20 min	38	35	30	27	24
Reshjet 10 min	32	29	25	22	19

Tabela Nr. 11 Intensitetet e reshjeve nga 24 orëshe deri në 10minuta me siguri të ndryshme për vendmatjen meteorologjike Peshkopi

Emërtimi	1%	2%	5%	10%	20%
Reshjet 24 orëshe	175	158	140	123	105
Reshjet 12orëshe	138	124	110	97	82
Reshjet 6 orëshe	109	98	87	77	65
Reshjet 2 orëshe	75	68	60	53	45
Reshjet 1 orëshe	59	53	47	41	35
Reshjet 30 min	46	41	37	32	28
Reshjet 20 min	40	36	32	28	24
Reshjet 10 min	32	29	26	22	19

Tabela Nr. 12 Intensitetet ( $\bar{i}$  mm/min) të disa rrebesheve karakteristike në Peshkopi

Viti	Data	Minuta									
		2	5	15	30	60	120	180	240	360	720
1943	22.XI	0	0	1.1	1.0	0.63	0.40	0.29	0.24	0.18	0.095
1961	14.XI	4.5	3.0	1.2	0.85	0.49	0.39	0	0.32	0.27	0.11
1962	15.XI	2.2	1.8	1.1	0.62	0.57	0.34	0.30	0.23	0.16	0.14
1964	31.V	1.8	1.4	1.1	0.80	0.50	0.37	0.33	0.30	0.22	0.13

Rrebeshet e jashtëzakonshëm kanë një dukje të rallë. Më 02.11.1957 një rrebesh i tillë ka rënë për 15 minuta 24mm dhe për 30 minuta 45mm.

Tabela Nr. 13 Sasitë më të mëdha të rrebesheve për intervale të ndryshme kohe të rënies

Vendmatja	Data	Minuta			Orë					Sasia totale	Koha totale
		2	15	30	1	2	4	6	12		
Peshkopi	14.XI.1961	10	15.5	0	0	0	0	101	151.5	151.5	11.50

Në tabelën Nr. 14 jepen disa reshje karakteristike me zgjatje 1 deri në 5 ditë që shkaktojnë plota të forta, si dhe vlerat mesatare vjetore të vendmatjes meteorologjike Peshkopi.

Tabela Nr. 14 Reshjet më të mëdha vjetore maksimale me zgjatje 1 deri 5 ditë gjatë periudhës së dhënë (mm)

Vendmatja	1 ditë	2 ditë	3 ditë	4 ditë	5 ditë	Reshjet mesatare
Peshkopi	185	214	155	160	193	1210
Burrel	218	242	261	295	309	1670

### 2.3 Bora

Në zonën në studim bora është një fenomen dhe kur bjen ajo krijon shtresë, dhe koha e qëndrimit të kësaj shtrese është e lartë.

Në të gjithë zonën çdo vit vrojtohen mesatarisht 1 deri në 5 ditë me borë. Këto ditë vrojtohen më tepër në muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor, Shtresa e borës qëndron gjatë vetëm gjatë dimrave të jashtëzakonshëm që shoqërohen me temperatura negative. Të tilla janë dimrat e viteve 1944-1945, 1949-, 1954-55, 1962-63 dhe vitet 1985, 2004. Në zonën në studim mesatarja e lartësisë maksimale është deri në 10cm, siç shihet në tabelën nr. 15 numri i ditëve me borë është 27 ditë në vite.

Tabela Nr. 15 Numri mesatar i ditëve me borë

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma Vjetore
Peshkopi	1.3	0.9	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.3	3.0
Burrel	8.0	6.0	4.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4.0	5.0	27

Sipas shpërndarjes së lartësisë maksimale të borës me siguri 2% (periudhë përsëritje një herë në 50 vjet) për zonën në studim lartësia është 42 cm. (Në marsin e vitit 1949 në Peshkopi kanë rënë 50 cm borë dhe temperatura negative ka arritur -13.0°C, të tilla parametra meteorologjike për Peshkopiin që ka filluar matjen e elementëve meteorologjik në vitin 1925 nuk janë arritur ndonjëherë deri më sot.

Në 30 vjet arrin 38cm, në 20 vjet 34 cm, dhe një herë në 10 vjet arrin në lartësinë 20cm borë.

### 2.4 Lagështia e ajrit

Si tregues i rëndësishëm i lagështirës së ajrit shërben lagështia relative e ajrit, e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik dhe njerëzor.

Siç shihet nga tabela Nr. 16, Ultësira Perëndimore, ku hyn dhe zona në studim, karakterizohet nga vlera mesatare vjetore të lagështirës relative të ajrit që luhatet nga 60% deri 70%.

Pjesa perëndimore e vendit tonë ku hyn dhe zona në studim ka vlera më të larta të lagështirës mesatare relative se sa pjesa e brendshme, kjo për arsye se pjesa perëndimore është nën ndikimin veçanërisht të theksuar të detit Adriatik.

Vlerat më të larta të lagështirës mesatare relative përgjithësisht vrotohen në periudhën e ftohtë të vitit që është e lidhur me veprimtarinë ciklonare që zhvillohet gjatë kësaj periudhe.

Siç shihet dhe nga tabela Nr. 16 vlerat më të larta i kanë muajt Nëntor dhe Dhjetor dhe më pas vjen Janari. Gjatë muajve të verës, vlerat mesatare të lagështirës së ajrit janë më të ulta sidomos në muajt korrik dhe gusht që janë muajt më të ngrohtë të vitit.

Duke u nisur nga amplituda vjetore, e gjithë zona në studim i përket regjimit detar.

Në zonën në studim, maksimumi i lagështirës relative bie në orën 4 dhe 5, ndërsa minimumi në orën 14 dhe 15. Në pjesën më të madhe të natës, lagështia relative qëndron pothuajse e pandryshuar.

Në zonën në studim numri mesatar i ditëve me lagështi relative  $\geq 80\%$  luhatet për Peshkopiin rreth 40.5 ditë.

Tabela Nr. 16 Mesataret mujore të lagështirës relative të ajrit në %

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes. Vjetore	Amplituda
Peshkopi	73	71	71	72	71	66	61	63	70	72	76	76	70	14

Një tregues karakteristik është dhe amplituda e lagështirës relative që vë në dukje ndryshimet që vërehen në vlerat e lagështirës relative gjatë ditës, muajt dhe vitit. Gjithashtu është karakteristike rritja e saj me shpejtësi nga vera në vjeshtë se sa ulja e saj nga dimri në pranverë. Kjo ndodh edhe për arsye të rritjes së shpejtë gjatë muajve të vjeshtës.

### 2.5 Stuhitë (Breshër)

Stuhitë për vendin tonë janë të shumta dhe ndodhin në të gjitha stinët e vitit. Shumë ditë me breshër ka në muajt e dimrit, gjysmën e dytë të vjeshtës dhe gjysmën e parë të pranverës dhe pak në korrik dhe gusht.

Tabela Nr. 17 Numri mesatar i ditëve me breshër

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Peshkopi	1.1	1.3	0.9	1.3	0.6	0.3	0.1	0.1	0.2	0.3	0.9	1.0	8.1

Si rregull, zgjatja e breshrit është 3 deri 5 minuta. Në zonën në studim breshëri vrotohet në çdo kohë të vitit, por më shumë në periudhën e ftohtë të vitit. Gjatë janarit pothuajse vrotohen ditë me breshër.

Në periudhën e ngrohtë të vitit numri i ditëve me breshër është i paket, gjithashtu stuhitë në vendin tonë mund të ndodhin në çdo muaj të vitit; kjo tregon karakterin mesdhetar që ka klima e vendit tonë.

Nga analiza e materialit mbi stuhitë me shumë ditë me stuhi ndodhin në pjesën perëndimore të vendit tonë. Konkretisht ka mesatarisht 30.3 ditë në vit me stuhi.

Në pjesën perëndimore të vendit tonë numri më i madh i ditëve me stuhi vrojtohet në muajin maj, gjatë këtij muaji ka 4 ditë me stuhi.

Shkaku kryesor që maksimumi i ditëve me stuhi vrojtohet në muajin maj dhe qershor duhet kërkuar në qarkullimin e masave ajrore dhe rastisjen e cikloneve.

Muaji maj përfshihet në periudhën e qarkullimit dimëror të atmosferës që zëvendësohet me qarkullimin veror, domethënë me ardhjen e masave ajrore nga deti në thellësi të territorit.

Tabela Nr. 19 Numri mesatar i ditëve me stuhi

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Peshkopi	1.8	1.9	1.5	2.4	4.1	2.7	2.8	2.1	2.2	2.8	3.4	2.4	30.3

## 2.6 Mjegulla

Mjegulla është një ngjarje atmosferike që vështirëson transportin rrugor, detar dhe ajror, sidomos kur ka intensitet të madh.

Në përgjithësi, si rregull, në brendësi të territorit hasen më shpesh në periudhën e ftohtë të vitit, ndërsa në bregdet gjatë periudhës së ngrohtë.

Për të analizuar këtë dukuri në zonën në studim do të ndalemi në dy aspekte: në numrin e ditëve me mjegull dhe zgjatja e saj në orë.

Tabela Nr. 20 Numri mesatar i ditëve me mjegull

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma Vjetore
Peshkopi	3.1	1.9	1.6	0.4	1.1	0.2	0.3	0.7	0.7	0.9	1.8	2.9	14.9

Në Peshkopi numri më i madh i ditëve me mjegull vrojtohet në periudhën e ftohtë të vitit (Tetor-Mars) 12.0 ditë, ku janari ka numrin më të madh të ditëve me mjegull.

Në dhjetor të vitit 1974 janë vrojtuar 20 ditë me mjegull në zonën në studim, gjë që përfaqëson një ngjarje atmosferike që realizohen një herë në 50 vjet. Gjithashtu në Peshkopi, më 29 dhe 30 Janar 1968 mjegull ka pasur një zgjatje maksimale pa ndërprerje 11 orë e 43 minuta.

## 2.7 Era

Regjimi i erës ka një rëndësi të veçantë si për formimin e klimës ashtu dhe për qëllime praktike (në projektimin e urave). Për të përshkruar regjimin e erës në zonën në studim do të bazohemi në vrojtimitet në vendmatjen meteorologjike të qytetit të Peshkopiit.

Në parametrat kryesorë të erës përfshihen të dhënat për drejtimin e saj (shpeshësia sipas drejtimeve të ndryshme) si dhe shpejtësia e saj sipas drejtimeve të ndryshme.



Tabela Nr. 21 Rastisja mesatare shumëvjeçare e drejtimit të erës dhe shpejtësia mesatare sipas drejtimeve në %.

Vendmatja	Qetësi %	N		N.E.		E		S.E.		S		S.W.		W		N.W	
		r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh
Peshkopi	44.0	3.5	2.7	2.8	2.0	3.4	1.5	15.8	2.5	4.4	2.4	7.1	2.7	3.9	2.5	5.2	2.9

r- rastisja  
sh- shpejtësia m/sek

Në vendmatjen meteorologjike Peshkopi, qetësia është 44% gjatë vitit. Shpejtësia mesatare sipas drejtimeve varion nga 1.5 deri në 2.9 m/s. Më e madhja është në drejtimin NW dhe më e vogla në drejtimin. Shpejtësia maksimale ka arritur në raste të veçanta atmosferike (tufane) deri në 40m/sek.

Siç shihet nga tabela Nr. 21 si drejtim i parë mbizotërues shfaqet në S.E. me frekuencë 15.78%. Ky drejtim karakterizohet nga një shpejtësi mesatare 2.5 m/s.




Fig. 3 Trëndafili i erës, Stacioni Peshkopi

Në vartësi të lëvizjeve të sistemeve barike dhe të orografisë së zonës që po studiojmë, era pëson ndryshime të rëndësishme,

Në tabelën nr. 22 jepen të dhënat e rastisjeve të shpejtësisë së erës në përqindje.

Tabela Nr 22 Rastisja e shpejtësisë së erës në %

Vendmatja	Shpejtësi 0-1 m/s	Shpejtësi 2-5 m/s	Shpejtësi 6-10 m/s	Shpejtësi 11-15 m/s	Shpejtësi >15 m/s
Peshkopi	58.7	37.0	4.0	0.2	0.1

Në tabelën Nr. 22 shihet se shpejtësia nga (0-1)m/s mbizotëron në përqindje të madhe, pak më pak shpejtësia (2-5)m/s, kurse shpejtësitë e tjera ulen shumë.

Gjatë ditës, era arrin shpejtësinë maksimale në orët e mesditës, dhe kjo lidhet me lëvizjet vertikale të masave ajrore, sidomos gjatë stinës së verës.

Erërat lokale në zonën në studim janë ato të brizave detare por janë të rralla dhe erërat veriore dhe lindore gjatë periudhës së ftohtë të vitit.

### 2.8 Diellzimi

Nohja e karakteristikave të diellzimit është e domosdoshme në projektimin e qendrave urbane. Madje, studimi i këtij elementi klimatik duke dhënë ligjshmërinë e tij në kohë dhe hapësirë për zonën në studim (që është dhe zonë bregdetare) është me vlerë praktike.

Në përgjithësi, studimi mbi këtë element u mbështet në analizën e karakteristikave kryesor të tij: zgjatja faktike e diellzimit, dhe numri i ditëve me diell.

Zgjatja faktike e diellzimit varet kryesisht prej gjerësisë gjeografike, pozicionit topografik. Më i rëndësishëm është pozicioni gjeografik i vendmatjen se sa elementi i diellzimit.

Zgjatja faktike e diellzimit për vendmatjen e Peshkopiit (që përfaqëson zonën në studim) u bë duke shfrytëzuar të dhënat shumëvjeçare të buletineve meteorologjike).

Vlerat më të larta të zgjatjes mujore të diellzimit vrojtohen në Korrik dhe Qershor kur është zgjatja më e madhe astronomike e ditës. Vlerat më të ulëta të sasisë të orëve me diell vrojtohen në muajin dhjetor, gjë që përkon edhe me zgjatjen më të vogël astronomike të ditës.

Tabela Nr. 23 Zgjatja faktike e diellzimit(orë)

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma Vjetore
Peshkopi	125	124	163	191	256	297	351	328	257	107	125	108	2532

Treguesi tjetër klimatik me interes është dhe numri i ditëve me diell. Nga një vështrim që mund t'i bëhet tabelës Nr. 24 vërehet në periudhën maj-shtator pothuajse nuk vrojtohet as një ditë pa diellzim. Shpërndarja territoriale e ditëve me diell përputhet me shpërndarjen territoriale të sasive të orëve me diellzim. Numri më i madh i ditëve me diell vrojtohet në stinën e verës, kurse në stinën e dimrit vrojtohet numri më i vogël i tyre.

Tabela Nr. 24 Numri mesatar i ditëve me diell

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Peshkopi	24	24	27	28	30	30	31	31	29	30	25	23	332

Siç shihet numri mesatar vjetor i ditëve me diell në zonën në studim është i konsiderueshëm, fakt që duhet t'i tërheqë akoma më tepër specialistët e urbanistikës, dhe të fushave të tjera të ekonomisë.

## 2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

### 2.1 – PROJEKTI I RRUGËS

Zona ne te cilin shtrihet objekti i kontrates Studim-Projektim **PERMISIMI I INFRASTRUKTURES VENDORE DHE RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN PRANE PALLATIT TE KULTURES “ Duke u mbeshtetur ne gjendjen ekzistuese si dhe prespektiven e zhvillimit te zones, jane parashikuar rikonstruksioni total i ketyre shesheve e rrugeve dhe sistemimi i ujrave te shiut , ndricimi dhe krijimimi i kendeve te lojrave per femije.**

Meqenese objekti do rikonstruktohen teresisht, ne zgjidhjen e projektit jane patur parasysh:

1. Zgjidhja ne anen Planimetrike
2. Zgjidhja ne anen Altimetrike
3. Elementet sociale

#### ■ Zgjidhja Planimetrike (nderhyrjet).

Ne zgjidhjen Planimetrike eshte patur parasysh sistemimi dhe riorganizimi i sheshit te ndermjetem si dhe i segmenteve rrugore konturues te bllokut ne fjale.

Nderhyrjet konsistojne ne:

#### ○ **Sistemimin e sheshit qendror**

Eshte bere riorganizimi i sheshit qendror duke e plotesuar me gjithe elementet e nevojshem urban, ne menyre qe zona ne fjale te kthehet ne nje mini-park te vogel i cili do i sherbeje jo vetem komunitetit perrreth por edhe me gjere. Ne te, jane parashikuar realizimi i rrugekalimeve per kembesoret, realizimi i gjelberimit te nevojshem (mbjelljen e siperfaqeve me bar, te shkurreve apo dhe pemeve), vendosjen e stolave, etj. Gjithashtu eshte parashikuar realizimi i nje kendi per lojrat e femijve, duke bere edhe shtrimin e siperfaqes perkatese me rere.

I gjithe parku do plotesohet me rrjetet perkatese inxhinierike, perfshire ketu ndricimin, rrjetin e largimit te ujrave siperfaqesore, realizimin e rrjetit te vaditjes, etj.

#### ○ **Rikonstruksioni dhe sistemimi i segmenteve rrugore konturuese.**

Jane parashikuar rikonstruksioni i plote i gjithe segmenteve rrugore ekzistues, duke patur parasysh riorganizimin e nyjeve rrugore perkatese si dhe realizimi i nje segmenti rrugor teresisht te ri ne pjesen jugore te bllokut. Gjate riorganizimit te nyjeve rrugore eshte patur parasysh permisimi i nyjeve aktuale dhe pershtatja e tyre me parametrat e permisuara te segmenteve rrugore.

Gjithashtu eshte patur parasysh krijimi i vend-parkimeve ne krah te rrugeve aty ku eshte e mundur.

Do realizohen trotuare per kalimin e kembesoreve si dhe jane parashikuar gjithashtu realizimi i rrjeteve inxhinierike te nevojshme si dhe sinjalistikes perkatese.

### ■ Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik eshte pothuajse e sheshte. Eshtë synuar që niveleta e tyre të jetë sa me pranë asaj ideale, por duke respektuar edhe kuotat e hyrjeve te objekteve ekzistuese. Gjithashtu eshte bere rakordimi ne kuote me rruget ekzistuese.

### ■ Profili Gjatësor

Profili gjatësor perfaqëson prerjen e rrugës apo shesheve sipas aksit të saj në drejtimin vertikal. Profili gjatësor është hartuar në shkallë Horizontale 1:1000 dhe shkallë Vertikale 1:100.

Në të janë paraqitur:

- ✚ Vija e Terrenit – Ngjyrë e Zezë
- ✚ Vija e Projektit – Ngjyrë e Kuqe
- ✚ Vija e Gërmimit – Ngjyrë Jeshile
- ✚ Disnivelet e Vijes së Projektit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Gërmimit
- ✚ Numri i Piketës (Seksionit)
- ✚ Kuota e Terrenit
- ✚ Kuota e Projektit
- ✚ Kuota e Gërmimit
- ✚ Distanca Pjesore
- ✚ Distanca Progressive
- ✚ Kryqëzimet
- ✚ Pjerrësitë e Niveletës
- ✚ Kilometrazhi

### ■ Profilat Tërthorë

Profilat tërthorë përfaqësojnë prerje të rrugës tërthor me aksin e saj në drejtimin vertikal. Profilat tërthorë janë hartuar në shkallë 1:100 (e njëjtë për dy drejtimet Vertikal dhe Horizontal)  
Në profilat Tërthorë janë paraqitur:

- ✚ Numri i Profilatit
- ✚ Distanca Progressive
- ✚ Sipërfaqja në Mbushje dhe Gërmim
- ✚ Vija e Terrenit – Ngjyrë e Zezë
- ✚ Vija e Projektit – Ngjyrë e Kuqe

- ✚ Vija e Gërmimit – Ngjyrë Jeshile
- ✚ Disnivelet e Vijës së Projektit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Gërmimit
- ✚ Numri i Piketës (Seksionit)
- ✚ Kuotat e Terrenit
- ✚ Kuotat e Projektit
- ✚ Kuotat e Gërmimit
- ✚ Distancat pjesore nga Aksi
- ✚ Distancat e përgjithshme nga Aksi.

### ■ Profilat Tip dhe Detajet

Në Profilat Tip, janë paraqitur në mënyrë të detajuar:

- ✚ Shtresat Rrugore
- ✚ Dimensionet e tyre
- ✚ Vendosja e tyre
- ✚ Distancat
- ✚ Zona ku aplikohet Profili Tip
- ✚ Pozicioni i rrjeteve të tjera inxhinierikë.

Në detaje janë paraqitur:

- ✚ Dimensionet e Bordurave
- ✚ Markat e Betonit
- ✚ Mënyra e fiksimit të Bordurave
- ✚ Mënyra e shtrimit të Trotuareve
- ✚ Vendkalimet për njerëzit me aftësi të kufizuar.

### ■ Zgjidhja Sociale.

Duke patur parasysh që rruga kalon në një zonë pothuajse të ezauruar nga ana urbane, është patur parasysh ruajtja e nivelit ekzistues të rrugës, duke mos sjellë diferenca kuote në lidhje me hyrjet e apartamenteve apo rezidencave.

### ■ Llogaritja e Shtresave të Rrugës

Nisur nga eksperinca në projektimin e rrugëve, studimi i trafikut të zones dhe prespektiven e zhvillimit, studimi gjeologjik, vleresimi i gjendjes aktuale, rezulton se në këto pjesë të rrjetit rrugor, janë të destinuara kryesisht për mjete të tonazhit të lehtë dhe të mesëm.

Meqenëse jemi në një zonë të formuar urbane, ku levizjet në kuote do të krijojnë probleme serioze në funksionimin e bllokut e sidomos në hyrje daljet e objekteve, u përcaktua që shtresat rrugore të ndërtohen teresisht të reja për segmentet që kanë demtime të theksuara si dhe të behen riveshje për pjeset që ka konsumim të tapetit



### Shtresat Rrugore

Ne rruget , ku do nderhyhet me pakete te plote:

Asfaltobeton	- 4cm
Binder	- 6 cm
Stabilizant	- 15 cm
Çakëll guroreje	- 40 cm
Gur kave	- 30 cm


Ne rruget ku do kete vetem riveshje:

Asfaltobeton	- 4 cm
Profilim me binder	

### Shtresat e Trotuarit

Pllake betoni	- 6cm
Rere	- 4 cm
Zhavorr/Çakëll	- 25cm

Shtresat e trotuarit do te ndertohen mbi trasene e ndertuar paraprakisht.



### Bordurat dhe KUNETAT

Trupi i rrugës (pjesa kaluese) do të kufizohet me bordurë Betoni Parafabrikat M-250 me përmasa 25x35 cm të fiksuara me beton M100-150. Bordura e rrugës do të vendoset mbi shtresat bazë të rrugës. (pasi mbi të në shumë raste takojnë apo ngjiten gomat e mjeteve.

**KUNETAT** (ne segmentet ku aplikohen) do të jenë e shtruar me Beton M-300 me gjerësi 50cm. Ato do vendosen paralel me rrugën. Kuneta do te kete trashësi mesatare 14cm. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës.

Ne trotuare, prane kryqezimeve, ne vendet e kalimit te kembesoreve jane parashikuar dhe rampat per kalimin njerezve me aftesi te kufizuar.

## Plan-Organizimi i Punimeve te Ndertimit

Para fillimit te punimeve, nga ana e kontraktorit do te paraqitet tek supervizori i objektit Plan-Organizimi per kantierin ne fjale. Ne kete faze nuk eshte paraqitur Plan-Organizimi, pasi dokumenti ne fjale ndryshon nga disponibiliteti i shoqerise ndertimore (kontraktorit) ne lidhje me makinerite, fuqine puntore, teknologjite ndertimore, etj..

### 2.2 - SINJALISTIKA RRUGORE

Eshtë parashikuar realizimi i Sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale.

**Sinjalistika Horizontale** e cila do të përbëhet:

1. Nga dy vija te vazhduara me gjeresi 12 cm ne ane dhe nje tjeter ne mes me vija te nderprera nese ka dy sense levizjeje, ose dy vija te vazhduara ne ane nese rruga eshte me nje sens levizjeje.
2. Ne kryqezime dhe vende te caktuara do jene vijat e lëvizjes së këmbësorëve dhe shigjetat e drejtimit te levizjes.
3. Vijeze jane parashikuar gjithashtu edhe ne zonen e shesheve per ndarjen e senseve te levizjes se automjeteve, vijezeimit te kembesoreve si dhe kufizimeve te vendparkimeve te automjeteve.

**Sinjalistika Vertikale** do të përbëhet nga

1. Tabelat Detyruese.
2. Tabelat Treguese.
3. Tabelat Paralajmëruese.

Të gjitha tabelat do vendosen në trotuare, ngjitur me bordure kufizuese te tij.

### 2.3 – KONKLUZIONE

Realizimi i punimeve per Projektin " PERMISIMI I INFRASTRUKTURES VENDORE DHE RIVITALIZIM I HAPSIRAVE PUBLIKE NE ZONEN PRANE PALLATIT TE KULTURES " do ti jape kesaj njesie administrative nje frymemarrje te re dhe do permiresoje ndjeshem cilesine e jeteses se banoreve te tij. Rikonstruksioni i saj do permiresoje ndjeshem qarkullimin e mjeteve perrreth dhe rise mirqenien e banoreve dhe shtimin e siperfaweve te gjelberta e rekreative .

Realizimi i tij, do krijoje akses ne zone edhe nga segmente te tjere te rrjetit rrugor te qytetit.

Realizimi i elementeve te tjere te infrastruktures urbane do kete nje impakt te ndjeshem. E ndjeshme do jete edhe permiresimi i cilesise se ajrit, duke ulur ne menyre te ndjeshme pluhurin dhe duke shtuar sasine e oksigjenit.

" STUDIO ARBI & ALB - SUPERVIZION D.S " sh.p.k

ING. IRAKLI DINAJ